

Vendim nr. 128 datë 10.06.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Genti Ibrahim,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 10.06.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 6 (E) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: **ETLEVA SELIMAJ**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-4318 (344), datë 19.10.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 29, 31, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 135 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkesja Etleva Selimaj (*kërkuesja*) në datën 03.08.2006 ka filluar punë në pozicionin e përgjegjëses së sektorit pranë drejtorisë së shërbimeve mbështetëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave.

2. Me shkresën nr. 779/1, datë 21.02.2014, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave ka bërë njoftimin për kalimin në listëpritje të kërkueses për shkak të ristrukturimit të institucionit, për të cilin ajo ka marrë dijëni në datën 24.02.2014. Ndërsa me urdhrin nr. 33, datë 25.02.2014 “Për kalim në listëpritje” (*urdhri nr. 33/2014*) të drejtorit të përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme Arkivave, bazuar në urdhrin e Kryeministrit nr. 47, datë 10.02.2014 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”, është vendosur kalimi në listëpritje për shkak të ristrukturimit të institucionit (shkurtim të vendit të punës).

3. Ndërkohë, Kuvendi në datën 30.05.2013 ka miratuar ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” (*ligji nr. 152/2013*), i cili parashikonte datën 01.10.2013 si momentin e hyrjes në fuqi (*neni 72*). Me hyrjen në fuqi të tij, u shfuqizua ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” (*ligji nr. 8549/1999*) dhe çdo dispozitë tjetër që ishte në kundërshtim me të (*neni 70*). Gjatë kohës që pritej hyrja në fuqi e ligjit, Këshilli i Ministrave ka miratuar aktin normativ nr. 5, datë 30.09.2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil””, me qëllim shtyrjen në kohë të efekteve të ligjit nr. 152/2013. Akti normativ ka hyrë në fuqi menjëherë dhe është miratuar nga Kuvendi me ligjin nr. 161/2013, datë 17.10.2013. Këto dy akte janë shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese (*Gjykata*) me vendimin nr. 5, datë 05.02.2014 (*vendimi nr. 5/2014*), i cili ka hyrë në fuqi në ditën e botimit në Fletoren Zyrtare nr. 18, datë 26.02.2014.

4. Kërkuesja, duke mos qenë dakord me urdhrin nr. 33/2014 të drejtorit të përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave për nxjerrjen në listëpritje, në datën 07.04.2014 i është drejtuar gjykatës me padi me objekt shfuqizimin e urdhrin dhe detyrimin për të hequr kërkuesen nga lista e pritjes, rikthimin e saj në vendin e punës dhe trajtimin me pagë sipas vendit të punës.

5. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 4912, datë 19.09.2014, ka vendosur rrëzimin e padisë me arsyetimin se në rastin e kërkueses nuk gjen zbatim ligji nr. 152/2013, por ligji nr. 8549/1999, pasi padia ishte depozituar pas hyrjes në fuqi të vendimit të Gjykatës. Sipas gjykatës administrative të shkallës së parë referuar ligjit të zbatueshëm nr. 8549/1999 dhe pamundësisë së sistemimit të kërkueses në vend tjetër pune, është çmuar i drejtë kalimi i saj në listëpritje dhe gëzimi i të gjitha të drejtave të nëpunësit, përfshirë edhe pagën për një vit.

6. Kërkuesja ka paraqitur ankim ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 3955, datë 17.11.2016,

ka ndryshuar vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke vendosur pranimin e padisë, konstatimin e pavlefshmërisë absolute të urdhrin nr. 33/2014 të drejtorit të përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, detyrimin për të kthyer kërkuesen në vendin e mëparshëm të punës ose në një vend të të njëjtit nivel dhe pagimin e pagës nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në rikthimin e saj në punë.

7. Ndaj vendimit ka ushtruar rekurs Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, duke kërkuar ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

8. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-4318 (344), datë 19.10.2023, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 3955, datë 17.11.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 4912, datë 19.09.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

9. Kërkuësja në datën 12.04.2024 i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të Kolegji Administrativ të Gjykatës së Lartë.

II

Pretendimet e kërkueses

10. **Kërkuësja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të:

10.1. *Së drejtës së aksesit në gjykatë*, pasi Gjykata e Lartë e ka vlerësuar themelin e çështjes në dhomën e këshillimit pa praninë e palëve dhe jo në seancë gjyqësore. Problematika dhe kompleksiteti i çështjes ishin të tilla që Gjykata e Lartë duhet të thërriste palët në seancë gjyqësore, për të garantuar aksesin dhe parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, pasi për çështjen kishte dy vendimmarrje të ndryshme të gjykatave më të ulëta dhe rekursi ishte paraqitur nga pala e paditur. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave nuk ka ngritur asnjë pretendim të ri nga ato të paraqitura gjatë gjykimit në Gjykatën Administrative të Apelit, ku u vendos në favor të kërkueses. Pavarësisht komunikimit të rekursit nga Gjykata e Lartë, kërkuësja ka vlerësuar se të gjitha pretendimet e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave kishin të bënin me qëndrimin e mbajtur nga ajo gjatë gjykimit, për të cilin kishte dhënë argumente dhe shpjegime të pasqyruara në fakte konkrete.

- 10.2. *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi Gjykata e Lartë duhet ta kishte vlerësuar çështjen duke marrë parasysh, krahas pretendimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të ngritura në rekurs, edhe pretendimet e ngritura nga kërkuesja gjatë gjykimit të çështjes në gjykatën e shkallës së parë dhe atë të apelit, dhe pas analizës së kuadrit ligjor duhet të linte në fuqi vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit.
- 10.3. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë përmban palët në gjykim, rrethanat e çështjes, pretendimet e palëve, por nuk përmban qartësisht ligjin e zbatueshëm dhe dispozitat konkrete ku është bazuar Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, si dhe vlerësimin e tij për çështjen. Në tërësinë e tij ai rezulton të jetë alogjik, kontradiktor, i paqartë ose në mungesë të elementeve formale për përmbajtjen e tij. Qëndrimi i Gjykatës së Lartë është i bazuar në një arsyetim formal dhe interpretim të ngushtë të së drejtës së aksesit, duke cenuar parimin e sigurisë juridike dhe të drejtat sociale të parashikuara në nenin 49 të Kushtetutës.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkueses

11. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Individit, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

12. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kritere paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që individit të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Në mbështetje të këtij kuadri kushtetues do të vlerësohet legjitimitimi, duke analizuar me radhë kriteret e pranueshmërisë së kërkesës.

13. Në lidhje me legjitimimin *ratione personae*, Kolegji vlerëson se kërkuesja, si individ, legjitimohet në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, sepse ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin janë dhënë vendimet objekt kundërshtimi në Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

14. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, Kolegji vlerëson se kërkuesja i është drejtuar Gjykatës duke kundërshtuar vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, për rrjedhojë ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, sepse nuk ka mjete të tjera veç ankimit kushtetues individual.

15. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Gjykata në jurisprudencën e saj, në rastet e kundërshtimit të vendimeve gjyqësore, ka llogaritur afatin ligjor 4-mujor duke filluar nga data e dhënies së vendimit nga gjykata që ka përfunduar procesin gjyqësor, nëse kërkuesi nuk provon në nivel kushtetues se ka marrë dijeni në një datë të ndryshme (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 12, datë 24.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në rastin konkret, Kolegji vëren se vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë mban datën 19.10.2023 dhe kërkuesja i është drejtuar Gjykatës në datën 12.04.2024. Kërkuesja bashkëlidhur kërkesës ka paraqitur *e-mail-in* e datës 15.12.2023 sipas së cilit Gjykata e Lartë po këtë datë i është dërguar vendimin në adresën e postës elektronike, për rrjedhojë Kolegji vlerëson se nisur nga kjo datë ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga ligji.

17. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, Kolegji konstaton se kërkuesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit, barazisë së armëve e kontradiktoritetit dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit dhe parimit të barazisë së armëve e kontradiktoritetit, kërkuesja në thelb ka parashtruar se çështja në Gjykatën e Lartë, për shkak të problematikës dhe kompleksitetit, duhet të ishte shqyrtuar në seancë gjyqësore me praninë e palëve për t’i dhënë mundësi për të parashtruar pretendimet e saj.

18. Gjykata ka vlerësuar se e drejta e palëve për të qenë të pranishme, për t’u mbrojtur e për t’u dëgjuar në procesin gjyqësor janë aspekte të rëndësishme të procesit të rregullt në kuptimin kushtetues. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t’u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit civil, por duhet që

legjislacioni procedural, në radhë të parë, dhe, më pas, gjyqtari gjatë gjykimit t'u japin mundësi të barabarta palëve për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (*shih vendimet nr. 43, datë 27.12.2022; nr. 8, datë 23.02.2021; nr. 37, datë 30.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Kërkesat kushtetuese të procesit të rregullt ligjor janë reflektuar në përmbajtjen e nenit 61 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, sipas të cilit shqyrtimi i rekursit në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, si rregull, bëhet mbi bazë të dokumenteve në dhomën e këshillimit (*pika 1*). Gjyqtari relator cakton datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit, duke urdhëruar njoftimin e palëve.

20. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkesja nuk ka paraqitur pretendime për mosmarrjen dijeni për datën e zhvillimit të seancës në Gjykatën e Lartë apo për mosnjoftimin e rekursit të ushtruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave. Pretendimi i saj lidhet me mënyrën e shqyrtimit të rekursit nga Gjykata e Lartë dhe vetëm me faktin që rekursi është shqyrtuar në dhomën e këshillimit. Kolegji vlerëson se ky pretendim nuk është i tillë që të vërë në dyshim respektimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, për sa kohë që Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vepruar në përputhje me kompetencat e tij dhe me rregullat procedurale që gjejnë zbatim gjatë kësaj faze të shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit dhe parimit të barazisë së armëve e kontradiktoritetit kërkesja nuk ka paraqitur argumente në nivel kushtetues, ndaj pretendimi nuk mund të merret në shqyrtim.

21. Pretendimin për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e sigurisë juridike, kërkesja, në thelb, e ka trajtuar në drejtim të qëndrimit të mbajtur nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë. Ky pretendim garantohet nga neni 42 i Kushtetutës, pra lidhet me procesin e rregullt ligjor, hyn në juridiksionin kushtetues dhe do të analizohet në vijim nga Kolegji.

B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me sigurinë juridike

22. Kërkesja ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë përmban palët në gjykim, rrethanat e çështjes, pretendimet e palëve, por nuk përmban qartësisht ligjin e zbatueshëm, dispozitat konkrete ku është bazuar Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në vendimmarrjen e tij, si dhe vlerësimin e tij për çështjen. Sipas kërkeses, në tërësinë e tij, ai

rezulton të jetë alogjik, kontradiktor, i paqartë ose në mungesë të elementeve formale për përmbajtjen e tij. Qëndrimi i Gjykatës së Lartë është i bazuar në një arsyetim formal dhe interpretim të ngushtë të së drejtës së aksesit duke cenuar parimin e sigurisë juridike.

23. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga neni 42 i Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, i cili përkon edhe me detyrimin e gjykatave për të arsyetuar vendimet, sipas nenit 142, pika 1, të Kushtetutës. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje dhe në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Me arsyetim, gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm që e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit, çka mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 42, datë 25.05.2017; nr. 25, datë 10.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Nga ana tjetër, Gjykata ka theksuar se kur pretendimi lidhet me mënyrën e interpretimit të ligjit, ajo ndërhyt vetëm kur interpretimi është arbitrar ose kur konstaton gabim ligjor aq evident që të karakterizohet si një gabim që asnjë gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose të jetë i tillë që të prishë drejtësinë e procesit (*shih vendimet nr. 67, datë 06.12.2023; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Po kështu, Gjykata, në mënyrë konstante, ka pohuar se shqyrtimi i çështjes nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit nuk është vetëm një konstatim formal i paraqitjes së shkaqeve ligjore në rekurs, por konsiston në vlerësimin e këtyre shkaqeve dhe bazueshmërisë së tyre, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 8, datë 26.02.2015; nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Kolegji vëren se kërkuësja i është drejtuar gjykatës së shkallës së parë duke kërkuar shfuqizimin e urdhrin nr. 33/2014 të drejtorit të përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave për nxjerrjen në listëpritje të kërkuëses, detyrimin për ta hequr nga kjo listë dhe për ta rikthyer në vendin e punës, si dhe trajtimin me pagë sipas vendit të punës.

27. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 4912, datë 19.09.2014, ka vendosur rrëzimin e padisë me arsyetimin se në rastin e kërkuëses gjen zbatim ligji nr. 8549/1999, pasi padia është depozituar pas hyrjes në fuqi të vendimit të Gjykatës. Sipas kësaj gjykate, referuar ligjit të zbatueshëm nr. 8549/1999, dhe pamundësisë së sistemimit të kërkuëses në vend tjetër pune, është vlerësuar i drejtë kalimi në listëpritje dhe gëzimi i të gjitha të drejtave të nëpunësit, përfshirë edhe pagën për një vit.

28. Pas ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, kjo e fundit, me vendimin nr. 3955, datë 17.11.2016, ka vendosur ndryshimin e vendimit e gjykatës së shkallës së parë, duke konstatuar pavlefshmërinë absolute të urdhrin nr. 33/2014 të drejtorit të përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, detyrimin për të kthyer kërkuësen në vendin e mëparshëm të punës ose në një vend të të njëjtit nivel dhe pagimin e pagës nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në rikthimin e saj në punë. Gjykata Administrative e Apelit ka vlerësuar se ligji i zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes është ligji nr. 152/2013, i cili ka hyrë në fuqi në datë 01.10.2013, pra rrjedhimisht edhe situata faktike juridike rregullohet nga dispozitat ligjore të këtij ligji.

29. Ndaj vendimit ka ushtruar rekurs Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, duke kërkuar ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë. Kërkuësja nuk ka paraqitur kundërrkurs sipas nenit 477 të Kodin e Procedurës Civile

30. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-4318 (344), datë 19.10.2023, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 3955, datë 17.11.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 4912, datë 19.09.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

31. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, fillimisht, ka arsyetuar se ai vëren se në mosmarrëveshjen administrative është mbajtur qëndrim i ndryshëm nga gjykatat e faktit për zgjidhjen e saj. Ndryshimi ka ardhur si pasojë e moszbatimit të duhur të normës ligjore, konkretisht të nenit 76 të ligjit nr. 8577/2000, që përcakton fuqinë prapavepruese të vendimeve të Gjykatës dhe rrjedhimisht mosidentifikimin e duhur të ligjit të posaçëm që rregullon

mosmarrëveshjen nga pikëpamja materiale. Sipas Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, Gjykata Administrative e Apelit nuk e ka identifikuar saktë ligjin e zbatueshëm. Ky kolegji ka vijuar në arsyetim se ligji nr. 152/2013 ka hyrë në fuqi në datën 01.10.2013, ndërsa vendimi i Gjykatës që e ka shfuqizuar si të papajtueshëm me Kushtetutës ka hyrë në fuqi në datën 26.02.2014, kohë në të cilën çështja objekt shqyrtimi nuk ishte regjistruar ende, pasi padia ishte regjistruar pas kësaj date, sikurse gjykatat referojnë në vendimmarrjet e tyre dhe veprimi administrativ i kundërshtuar ishte mbështetur në ligjin nr. 8549/1999. Në ligjin nr. 8577/2000 parashikohet se vendimet e Gjykatës sjellin efekte juridike nga data e hyrjes së tyre në fuqi. Përjashtimisht, ligji ka pranuar që në raste të veçanta të specifikuara në nenin 76, pika 2, vendimet e Gjykatës janë me efekt prapaveprues. Sipas Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, në rastin objekt gjykimi nuk jemi përpara asnjërit prej rasteve të parashikuara në nenin 76, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka një qëndrim të konsoliduar për rastet e shqyrtimit të fuqisë prapavepruese të vendimit të Gjykatës në raport me konfliktet e marrëdhënieve të punës për punëmarrësit që gëzojnë statusin e nëpunësit civil dhe kur marrëdhënia e punës është ndërprerë përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013. Për rrjedhojë, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se ligji i zbatueshëm në mosmarrëveshjen konkrete është ligji nr. 8549/1999 dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka identifikuar drejt ligjin material (*shih paragrafët 20-23 të vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

32. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se nga përmbajtja e vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nuk rezulton që ai të ketë kundërthënie, të jetë i paqartë dhe të mos ketë respektuar standardet e arsytimit të vendimit gjyqësor. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim përmbajtjen dhe procedurën për nxjerrjen e aktit të kundërshtuar, si dhe e ka analizuar atë në raport me dispozitat ligjore të zbatueshme, ka konkluduar me zgjidhjen në themel të padisë. Gjithashtu, Kolegji vëren se nga analiza e argumenteve nuk konstatohet që kërkuësja të ndodhet në kushtet e ndonjë të drejte të fituar nga ligji ose nga gjykata me vendim gjyqësor të formës së prerë, e cila të jetë vënë në dyshim nga vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë e ka interpretuar ligjin brenda kompetencave kushtetuese të saj si gjykatë ligji dhe interpretimi konkret nuk rezulton të jetë haptazi i paarsyeshëm e në shkelje të nenit 42 të Kushtetutës.

33. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e sigurisë juridike është haptazi i pabazuar.

34. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronjat “a” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.